

EVIS HUDHËRA

SINONIMIA TE MBIEMRAT MARRËDHËNIORE

a. Sinonimia si kategori semantike

Sinonimia është një kategori semantike dhe një relacion leksiko-semantik që karakterizon edhe mbiemrat marrëdhëniorë, edhe pse kjo ka kushtëzimin e vet, që buron jo vetëm nga kategorialiteti semantik i përmbajtjes së klasës së mbiemrave, por edhe nga tema motivuese, morfologjike e semantike, nga janë formuar këtë mbiemra. Gjatë shpjegimit kuptimor tek një grup paradigmatic njësisht nga këta mbiemra mund të vendoset lehtësisht një lloj sinonimie gramatikore, si *monedhë ari / monedhë e artë*, ku mbiemri hyn në marrëdhënie kuptimore afrie me emrin në rasën rrjedhore.

b. Kuptimi i mbiemrave marrëdhëniorë

Sipas *Gramatikës së gjuhës shqipe*, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Mbiemrat marrëdhëniorë e japin tiparin e sendit, emrin e të cilit karakterizojnë, nëpërmjet emërimit të marrëdhënieve të këtij sendi me një send tjetër ose me një rrethanorë, me një veprim a me një numër. Pra, këta mbiemra emërtojnë marrëdhënie e mësipërme, por këto, i japin si tipare tipike e të qëndrueshme të sendeve. Në këtë vështrim këta mbiemra për një pjesë të mirë të kuptimit të tyre janë sinonimikë me rasat e zhdrejta të emrave, që përbëjnë temën fjalëformuese të tyre, p.sh: *shall i leshtë – shall (prej) leshi, buzëqeshje fëminore – buzëqeshje fëmije (fëmijësh), rreze diellore – rreze dielli, diell pranveror – diell pranvere, shtyllë e mermertë – shtyllë (prej) mermeri*. Edhe me emrat në rasat e zhdrejta shprehen marrëdhënie midis sendeve. Madje, disa herë këto rasa janë të vetmit shprehës të marrëdhënieve, pra, gjuha nuk ka krijuar për këto mbiemrat marrëdhëniorë përkatës, p.sh.: *qëndrim çilimiu, qumësht lope, mish bualli* etj. Por këto marrëdhënie emrat e mësipërm nuk i japin gjithmonë si tipare të qëndrueshme të një sendi, por më shpesh si marrëdhënie konkrete, që dalin në raste të veçanta. Te mbiemrat marrëdhëniorë, përkundrazi, marrëdhënia jepet si një tipar i qëndrueshëm e i abstraktuar, si kuptim kategorial. Pra, ndryshimi themelorë i këtyre mbiemrave nga format e zhdrejta rasorë të emrave përgjegjës qëndron pikërisht në kuptimin e përgjithshëm kategorial të tiparit; këta mbiemra kanë aftësi më të mëdha përgjithësuese, tipizuese sesa rasat e zhdrejta të emrave.”¹

c. Ndarja e mbiemrave marrëdhëniorë në nëngrupe

Sipas *Gramatikës së gjuhës shqipe*, në mbiemrat marrëdhëniorë bëjnë pjesë mbiemrat lëndorë, përkatësorë dhe sasiorë.

¹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156

1. Mbiemri marrëdhëniorë mund të shprehë një *marrëdhënie lëndore*, d.m.th. ta përcaktojë sendin e dhënë për nga lënda prej së cilës ai përbëhet: *rreth i artë, kullë e gurtë, derë e hekurt, fustan i mëndafshhtë, bluzë e pambuktë* etj.²

Zakonisht këta mbiemra në kuptimin parë, të drejtpërdrejtë, për të cilin kanë lindur dhe me të cilin janë futur në përdorim, nuk krijojnë marrëdhënie sinonimike me njësi të tjera mbiemërore. Sepse, siç do të shihet edhe vetë emërtimi një lënde, emërtim që ka shërbyer si temë fjalëformuese për mbiemrin, nuk ka sinonimi. Këtu nuk po ndalemi tek emërtimet e ndryshme që gjenden në dialekte dhe në të folme krahinore për një lëndë të caktuar. Ato në vetvete nuk janë sinonime, por dalin si të tilla kur vendosin marrëdhënie me një fjalë të mbarë shqipes. Këtu bën përjashtim mbiemri i artë që del sinonim me mbiemrin i florinjte.

2. Mbiemri marrëdhëniorë mund të shprehë një *marrëdhënie përkatësore*, d.m.th. ta përcaktojë sendin e dhënë për nga përkatësia e tij (në kuptimin më të gjerë të fjalës), nëse i përket një sendi, një vete a një koncepti abstrakt: *shtëpi atërore, kushte agroteknike, armë atomike, stili deradian, gabim ideor, dukuri natyrore, trup qiellor, plan shtetëror* etj.³ Edhe në njësitë mbiemërore të këtij grupi paradigmatic mungojnë marrëdhëniet sinonimike nëse mbiemrat janë njëkuptimësh; mungojnë edhe dhe në kuptimin e tyre të parë kryesor, të mirëfilltë, nëse janë shumëkuptimësh. Mjafton të kërkojmë në *Fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe*, 2004 dhe nuk do të gjejmë sinonime të këtyre mbiemrave në këtë parametër.

ATËRÓR,~E mb. libr. 1. Që i përket atit, i babait; që vjen, që rrjedh nga babai. *Shtëpia atërore. Trashëgim atëror. E drejta atërore. drejt. Fisi atëror. etnogr.*

2. Që është tipar dallues për babanë, për prindërit, që është veti e babait. *Kujdes atëror. Dashuri atërore. Këshillë atërore. Në mënyrë atërore.*

SHTETËRÓR,~E mb. 1. Që ka të bëjë me shtetin, që i përket shtetit, i shtetit. *Organizimi shtetëror. Administrata (organet) shtetërore. Aparati shtetëror. Pushteti shtetëror. Prone shtetërore. Kufiri shtetëror. Sektori shtetëror i ekonomisë. Ndërmarrje shtetërore. Instituti shtetëror i arkave të kursimit dhe sigurimeve. Hua shtetërore. Disiplina shtetërore. Sekretet shtetëror. Në rrugë shtetërore.*

2. Që ushtrohet a që bëhet nga shteti; që vendoset nga shteti. *Tregti shtetërore. Kontroll shtetëror. Çmime shtetërore.*

Edhe për katër nëngrupet e mëposhtme të mbiemrave marrëdhëniorë mungojnë marrëdhëniet sinonimike, nëse mbiemrat janë njëkuptimësh; mungojnë edhe dhe në kuptimin e tyre të parë kryesor, të mirëfilltë, nëse janë shumëkuptimësh. Po japim nga një shembull për secilin grup me mbiemra.

² *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156

³ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156

Sinonimia te mbiemrat marrëdhëniorë

3. Mbiemri marrëdhëniorë mund të shprehë edhe *marrëdhënien e sendit të dhënë me një veprim*: *makinë korrëse*, *makinë mbjellëse*, *qëndrim mohues*, *trup rrezatues*, *brisk rrues*, *gisht tregues* etj.;⁴

KÓRRËS, ~E mb. Që shërben për të korrur. *Makinë korrëse.*

4. Mbiemri marrëdhëniorë mund të shprehë edhe *marrëdhënien e sendit të dhënë me një çast kohor*: *ngjarje e djeshme*, *mbjellja e nesërme*, *prodhimi i sivjetshëm*, *gazeta e sotme*, *orët e vona* etj.;⁵

NËSËRM (i), ~E (e) mb. 1. Që vjen fill pas ditës së sotme; që i përket ditës pas së sotmes. *Dita e nesërme. Data e nesërme. Puna e nesërme. Mësimet e nesërme.*

2. Që i përket një të ardhme je të afërt; që do të jetë në një të ardhme të afërt, i ardhshëm, i së ardhmes. *Fshati i nesërm. Njeriu i nesërm. Mësuesit e nesërm.*

5. Mbiemri marrëdhëniorë mund të shprehë edhe *marrëdhënien e sendit të dhënë me një pikë hapësinore*: *pamje e jashtme*, *agjencia e këtushme*, *kati i poshtëm*, *dhoma e sipërme* etj.;⁶

KËTÚSH/ËM (i), ~ME (e) mb. Që është këtu, që ndodhet a që bëhet në këtë vend ku jemi ose në vendin për të cilin flitet, i këtij vendi; nga ky vend, që jeton a banon në këtë vend; *kund. i atyshëm; i atjeshëm. Njerëzit e këtushëm. Gjendja e këtushme. Gazetat e këtushme. Jeta e këtushme. Është i këtushëm.*

6. Mbiemri marrëdhëniorë mund të shprehë edhe *marrëdhënien e sendit të dhënë dhe me një numër*: *viti i katërt*, *pranvera e njëzetë*, *student i parë*, *radha e tetë* etj.;⁷

KÁTËRT (i,e) num. rresht. 1. Që i përgjigjet numrit katër në një varg të pandërprerë njerëzish a sendesh, në një radhë a renditje, në një klasifikim etj., që vjen menjëherë pas të tretit. *Radha (banka) e katërt. Dita e katërt. Muaji (viti) i katërt. Klasa e katërt. Në orën e katërt të mësimi.*

2. *përd. em. f.* Një nga të katër pjesët e barabarta, në të cilat ndahet një e tërë. *Një e katërta. Tri të katërtat.*

3. *Përd. em. sipas kuptimit 1 të numërorit rreshtor. E katërta C. Doli i katërti.*

⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156.

⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156.

⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156.

⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156.

